



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 355/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterave në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Gjakovë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjakovë, i shqiptohet dënim i gjobës në vlerë prej 1500 (njëmijepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, në fshatin Korenicë, komuna e Gjakovës, anëtarë të subjektit politik PDK kanë vendosur posterë të kandidatit nga ky subjekt Hajdar Beqa mbi lajmërimë të kësaj rruge. Parashtreesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bëre shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nenit 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe nenit 3.4 e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013. Parashtreesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës foto në cilësinë e provës.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara me nenin 33 pika b të LZP-së, janë të pa baza, sepse sipas këtij subjekti persona të paidentifikuar kanë vendosur posteret e kandidatit për kryetar të Komunës së Gjakovës, Hajdar Beqa, në anën e prapme të shenjave të komunikacionit, me qëllim të dëmtimit të PDK-së, mirëpo edhe përkundër kësaj subjekti politik i PDK-së, thotë se aktivistet tanë kanë hequr flamujt nga vendet për të cilat është ankuar LVV.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas parashtreesit të ankesës, subjekti politik PDK, ka vendosur posterin e kandidatit nga ky subjekt, në shenja publike të trafikut, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politik, që kanë të bëjnë me

vendosjen e njoftimeve, pllakateve, dhe posterëve, në lidhje me fushatën zgjedhore, në apo mbi rrugë publike, në shenjet publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e ofruar si provë, e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës nga parashtruesi i ankesës, shihet qartë se posteri i kandidatit nga radhët e subjektit politik të PDK-së, është vendosur në shenjen publike të trafikut, të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik PDK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posteri i kandidatit të PDK-së, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave dhe po ashtu subjekti politik në fjalë shkeljen e të njëjtës natyre e ka përsëritur edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjës në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimini e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Prandaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur nen 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit nga ky subjekt, është i vendosur në shenja publike të trafikut, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëherëshme të subjektit politik PDK, për evitimini e shkeljes së supozuar, veprime të cilat subjekti politik në fjalë i ka mbështetur me fotografi si dëshmi nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar, si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura ne përgjigje te ankesës andaj në kuptim te nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 355/2013 më datën 31.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkasat për ri-apelime se pse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nemin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetëkatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çëshja prek një të drejtë themelore.